



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 239/5 prot.

Tiranë, më 14.6.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 767, datë 29.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.5.2024, është njoftuar vendimi nr. 767, datë 29.5.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, ish-inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 767, datë 29.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, me vendimin e datës **.3.2013, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar në detyrën e inspektore me mandat 5-vjeçar pranë këtij institucioni¹. Me vendimin e datës **.5.2018, znj. Zhilla i është zgjatur mandati i inspektorit

¹ Komisionit, lidhur me pozicionin e znj. Sofia Zhilla, nga informacioni i administruar i ka rezultuar se: (1) me vendimin e datës **.11.1993 të KLD-së është emëruar ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Durrës; (2) me vendimin e datës

deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rezulton se, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, znj. Sofia Zhilla bën pjesë në subjektet e rivlerësimit që i përkasin kategorisë së rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijon: (1) plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas Shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31; (2) plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas Shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë AKSIK, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35; (3) plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas Shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

3. Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, rezulton se gjatë hetimit administrativ, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), ndër të tjera, është administruar edhe një kopje e vendimit nr. ***, datë **.10.2019, e këtij Institucioni, sipas të cilit është deklaruar mospasja e statusit “Magjistrat” për znj. Sofia Zhilla. Ky vendim është ankimuar nga znj. Zhilla pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. **, datë **.2.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paditëses Sofia Zhilla. Ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë, ku ende kjo çështje ndodhet në pritje për t’u shqyrtuar.

4. Gjithashtu, ka rezultuar se KLGJ-ja, me urdhrin nr. ***, datë **.11.2019, e ka *liruar* znj. Sofia Zhilla nga detyra e inspektorese së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkak të mospasjes së statusit të magjistratit. Urdhri nr. ***/2019, “Për lirimin nga detyra”, rezulton të jetë ankimuar nga znj. Zhilla dhe, në vijim, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2020, ka pranuar kërkesën e paditëses (Zhilla), duke shfuqizuar urdhrin për lirimin nga detyra të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me pasojë ndërprerjen e marrëdhënies së punës me KLGJ-në. Ky vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë (nr. ***, datë **.6.2020) është apeluar nga KLGJ-ja pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

5. Më tej, Komisioni, me shkresën e datës **.9.2023, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për të pasur më shumë informacione mbi ecurinë e kësaj çështjeje dhe kjo e fundit, me përgjigjen nr. ***/* prot., datë **.9.2023, ka bërë me dije se çështja në fjalë ende është në pritje të një planifikimi për t’u shqyrtuar/gjykuar. Në këto kushte, sipas përgjigjes së KLGJ-së, për sa kohë vendimi nr. ***, datë **.6.2020, nuk është zbatuar prej tyre, pasi nuk është i formës së prerë apo i ekzekutueshëm, znj. Zilla aktualisht rezulton në mospasjen e kriterëve plotësues të ekzistencës së statusit të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk gëzon as statusin e magjistratit dhe as pozicionin e inspektorese që mbulonte më herët.

6. Në vijim të procedurave administrative, Komisioni i ka njoftuar subjektin të rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, çeljen e hetimit administrativ, si dhe përbërjen e trupit gjykues.

**3.1995, është transferuar, po si ndihmësgjyqtare, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë; (3) me vendimin e datës **2.1996, të KLD-së, znj. Zhilla është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë; (4) më pas, me vendimin e datës **3.1999, të KLD-së, znj. Zhilla është shkarkuar nga detyra e gjyqtarese, me motivacionin “Për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”. Në vijim, znj. Zhilla, gjatë viteve 1999-2003, ka punuar në profesionin e lirë të avokates pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë e, më pas, është emëruar specialiste finance në Sektorin e Prokurimeve Publike pranë Presidencës.

Subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur këtij njoftimi të kryer në mënyrë të përsëritur dhe të shtrirë në një periudhë të gjatë kohore.

7. Më tej, pasi është kontaktuar me telefon nga Sekretaria gjyqësore, znj. Zhilla e ka konfirmuar disponimin dhe saktësinë e adresës së *email*-it, në të cilin ajo ishte kontaktuar edhe më herët nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti ka bërë me dije se ajo ka rreth 3 vjet që është larguar nga detyra dhe *nuk është më subjekt rivlerësimi e as nuk është më e interesuar për procesin e rivlerësimit.*

8. Në vijim, gjendur sërish në mungesë të një përgjigjeje me *email* nga subjekti, Komisioni ka nisur në banesën e subjektit të rivlerësimit shkresën e datës ****.5.2023, me qëllim arritjen e komunikimit lidhur me këtë proces, duke i ritheksuar nevojën për bashkëpunim nga ana e saj. Në përgjigje të sa më sipër, duke pretenduar se nuk është më subjekt rivlerësimi, me shkresën *e datës ***.6.2023, znj. Zhilla ka përcjellë pranë Komisionit një kërkesë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe kësisoj mosvijimin e proceduarave të hetimit administrativ ndaj saj.

9. Më tej, pasi edhe disa *email*-e të mëpasshme drejtuar subjektit kanë mbetur pa përgjigje, në këto kushte, Komisioni iu drejtua sërish subjektit me shkresën e datës ****.6.2023, duke i kërkuar që të shprehet në lidhje me pasojat e mundshme të ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, si dhe në raport me nevojën dhe vullnetin e saj për të marrë pjesë në një seancë publike mbi procesin e rivlerësimit ndaj saj.

10. Nëpërmjet përgjigjes shkresore të datës ****.7.2023, znj. Zhilla, duke përmbledhur dinamikën e lirimimit të saj nga detyra, të *datës ***.11.2019, ka pretenduar (sërish) që të mos jetë subjekt rivlerësimi, duke konfirmuar kërkesën për ndërprerje/pushim të procesit të rivlerësimit ndaj saj. Gjithashtu, në këtë shkresë/përgjigje (datë ****.7.2023), duke iu referuar sa i ishte kërkuar nga Komisioni, znj. Zhilla është shprehur se ajo nuk ishte e interesuar për të marrë pjesë në një seancë publike lidhur me procesin e saj të rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

11. Komisioni ka konstatuar se znj. Sofia Zhilla, në momentin e hyrjes në fuqi të dispozitave të lartpërmendura, ka qenë me funksion inspektore pranë ish-KLD-së, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.

12. Komisioni, pasi u njoh me vendimin nr. *****, datë ****.10.2019, me të cilin KLGJ-ja ka deklaruar mospasjen e statusit “Magjistrat”, si dhe me urdhrin nr. *****, datë ****.11.2019, me të cilin ky institucion e ka liruar nga detyra e inspektore znj. Zhilla dhe ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, Sofia Zhilla, nuk e ka statusin e magjistratit dhe as nuk gjendet më në pozicionin e inspektore, ka vlerësuar se në këtë kontekst të veçantë dhe për shkak të efekteve e pasojave të shkaktuara nga aktet e sipërcituara, znj. Zhilla (ndërkohë) ka humbur edhe statusin e subjektit të rivlerësimit, duke arsyetuar, ndër të tjera, sa në vijim:

13. *Lidhur me statusin e znj. Sofia Zhilla në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016.*

13.1 Në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, znj. Sofia Zhilla ka qenë duke kryer funksionin e inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, bazuar në: (i) pikën 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; (ii) ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; (iii) ligjin nr.

84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” – asokohe znj. Sofia Zhilla ka plotësuar kushtet e mbartjes së statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio*.

13.2 Në kuptim të dispozitave ligjore të zbatueshme², rezulton se inspektorët pranë KLD-së mund të ishin inspektorë që vinin nga sistemi gjyqësor dhe gëzonin statusin e gjyqtarit, si dhe inspektorë që vinin nga jashtë sistemit gjyqësor, që nuk gëzonin statusin e gjyqtarit, por kishin punuar dikur si gjyqtarë.

13.3 Nisur nga parashikimi i pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që ka arsyetuar se subjektet e rivlerësimit që i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio* janë të gjitha ato që në momentin e hyrjes në fuqi të listuar në nenin 197/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, Komisioni ka vlerësuar se në kushtet kur znj. Zhilla është emëruar si inspektore në KLD nga jashtë sistemit gjyqësor (pasi ajo nuk gëzonte statusin e gjyqtarit, sipas vendimit të KLGJ-së), por në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, ajo gëzonte statusin e inspektorit jomagjistrat pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pozicion ky që e kualifikonte/përfshinte atë mes subjekteve që i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit *ex officio*.

14. Lidhur me dinamikën evoluese të rrethanave faktiko-ligjore dhe me vlerësimin nëse znj. Sofia Zhilla mbart edhe aktualisht statusin e subjektit të rivlerësimit *ex officio*.

14.1 Nisur nga sa është përshkruar më sipër dhe nga fakti që znj. Zhilla në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese kishte statusin e inspektorit jomagjistrat dhe, bazuar në nenin 165 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit ajo mund të vazhdonte të qëndronte në këtë detyrë, përveçse kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, vlen të çmohen në dinamikën e tyre kohore rrethanat faktiko-ligjore të çështjes në analizë.

14.2 Vërehet se dispozita e lartpërmendur parashikonte se inspektori i KLD-së duhej t'i nënshtrohej testimit në Shkollën e Magjistraturës dhe, nëse arrin të paktën 60% të pikëve të testit të aftësive profesionale, përfitonte të drejtën që të ndiqte programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës³. Në rastin konkret rezulton se znj. Zhilla nuk i është nënshtuar testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës dhe, me vendimin e datës **.10.2019, ka vendosur deklarinimin e mospasjes së statusit “Magjistrat” dhe duke ndërprerë marrëdhënien e punës me të.

14.3 Nisur nga sa më lart, Komisioni, pavarësisht formës së largimit nga detyra duke u shkarkuar/liruar nga funksioni, në kuptimin formal dhe ligjor, por duke u fokusuar te pasojat ligjore, pra në faktin që ajo aktualisht nuk është më e punësuar pranë këtij organi (KLGJ-së) duke mbajtur në vëmendje disa elemente të kuadrit faktiko-juridik të kësaj çështjeje⁴, çmon se

² Ligji nr. 8811/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, neni 141; neni 282 i ligjit nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 153 të ligjit nr. 8811/2001; Rregullore nr. 195/2/a, datë 5.7.2006, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në nenin 18 parashikohet se: “2. Kryeinspektori apo inspektori [...] në përfundim të mandatit me kërkesë të tij riemërohet pa konkurs në funksionin e gjyqtarit, në gjykatën e fundit ku ai ka punuar në këtë funksion dhe me pëlqimin e tij, në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të lartë”.

³ Gjithashtu, në pikën 9 të kësaj dispozite parashikohet se nëse inspektori në detyrë kalon me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk ndjek fushën e karrierës së magjistratit, ka të drejtë për t'u caktuar në një pozicion si nëpunës civil në sistemin e Prokurorisë ose nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor.

⁴ Komisioni ka arsyetuar se znj. Zhilla: (i) nuk e ka statusin e magjistratit; (ii) nuk e ka më funksionin e inspektore dhe nuk është larguar nga ky pozicion me dorëheqje; (iii) nuk mbulon aktualisht asnjë pozicion në sistemin e drejtësisë; dhe (iv) ka paraqitur një kërkesë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit – çmon se znj. Sofia Zhilla aktualisht nuk mban më statusin e subjektit të rivlerësimit.

znj. Sofia Zhilla, aktualisht, nuk mban më statusin e subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, nisur edhe nga kërkesa e saj, çmohet se procesi i rivlerësimit për këtë subjekt duhet të përfundojë pa një vendim përfundimtar. Kjo, pasi vlerësohet se në mungesë të statusit të magjistratit, siç është rasti konkret, në momentin që subjektit të rivlerësimit i ndërpritet detyra funksionale – si element përcaktues që e ka cilësuar atë si një subjekt që duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio* – rrjedhimisht, humbja e funksionit/detyrës në fjalë e zhvesh atë edhe nga cilësimi si subjekt rivlerësimi, duke mos e legjitimuar vijueshmërinë e mëtejshme të këtij procesi.

14.4 Komisioni vëren gjithashtu se, në këto kushte, vijimësia hipotetike e procesit të rivlerësimit, i cili në përfundim do të duhej të konkludohej me një vendim përfundimtar duke u shprehur, si zakonisht, me një dispozitiv mbi konfirmimin, pezullimin apo shkarkimin e subjektit nga detyra, në këtë rast nuk mundësohet, pasi subjekti nuk është më në këtë detyrë për shkaqe të tjera. Kësisoj, kjo rrethanë specifike e bën të pamundur vijimin dhe konkludimin e procesit të rivlerësimit të znj. Sofia Zhilla, për sa kohë ka munguar qëllimi i këtij procesi rivlerësimi, duke e bërë kështu të pamundur përfundimin e këtij të fundit.

14.5 Në rrethanat dhe për shkaqet e lartpërmendura, Komisioni çmon se në rastin konkret gjen aplikim neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, i ndryshuar e, për pasojë, procesi i rivlerësimit për znj. Sofia Zhilla duhet të deklarohet i përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se ajo ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit.

15. Lidhur me aplikimin e mundshëm të nenit G, pika 2 e aneksit të Kushtetutës

15.1 Komisioni, në vijim të sa është përshkruar e argumentuar më sipër, konstaton se mosvijimi në pozicionin e inspektores – si shkak përcaktues për humbjen e cilësimit si subjekt rivlerësimi – ka ardhur jo për vullnetin e znj. Zhilla, e cila nuk ka paraqitur dorëheqje për t'u larguar nga funksioni i saj. Kësisoj, nuk evidentohet asnjë veprim i vullnetshëm i saj me qëllim shmangien nga nënshtrimi në procesin e rivlerësimit *ex officio*. Gjithashtu, edhe kërkesa e znj. Zhilla për “ndërprerjen/pushimin” e procesit të rivlerësimit, që ka përcjellë pranë Komisionit (në përgjigje të ftesës që i ishte bërë për t'u aktivizuar si pjesë/palë e këtij procesi), nuk mund të vlerësohet si një dorëheqje, por si një kërkesë për të evidentuar stadin aktual faktik, që nuk e cilëson më atë si një subjekt rivlerësimi.

15.2 Gjithashtu, Komisioni ka mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet në jurisprudencën e Kolegjit⁵, që lidhur me këtë pikë, veç të tjerash, është shprehur se në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, vullneti i subjekteve për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit dhe se çdo largim i vullnetshëm nga detyra (me dorëheqje) bënte të aplikueshëm pikën 2, të nenit G, të aneksit të Kushtetutës – si pasojë ligjore që sjell dorëheqja nga detyra, duke ndërprerë ecurinë e procesit të rivlerësimit deri në përfundim.

15.3 Në këto kushte, deduksioni logjik konsiston në faktin se askujt prej atyre që mund ta kenë humbur statusin e subjektit të rivlerësimit jo për vullnetin e tyre, pra pa dorëheqje, nuk mund t'i aplikohet ndalimi i parashikuar nga neni G, pika 2 e aneksit të Kushtetutës. Duke qenë se rasti konkret gjendet në këto kushte, për sa kohë humbja e pozicionit funksional të inspektores

⁵ Vendimet nr. 29 (JR), datë 7.10.2021 - prg. 11-14; nr. 32 (JR), datë 14.10.2021 - prg. 13.9 -13.18 dhe nr. 21, datë 17.6.2022 (JR) - prg. 15.11.

ka ardhur për shkak të lirimit nga detyra dhe jo nga dorëheqja, në konkluzion, Komisioni çmon se për znj. Sofia Zhilla nuk duhet të aplikohet pika 2, e nenit G, të aneksit të Kushtetutës.

15.4 Në përfundim, Komisioni, mbështetur në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në pikën 2/b të nenin 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, me shumicë votash⁶, ka vendosur:

- *Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Sofia Zhilla pa një vendim përfundimtar, për shkak se ajo ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit.*

III. Shkaqet e ankimit

16. Komisioneri Publik, në vlerësim të rrethanave dhe fakteve të administruara nga Komisioni, për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, në konsideratë të qëllimit të përcaktuar nga neni 179/b i Kushtetutës, jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit për rastet e ndërprerjes/përfundimit të procesit të rivlerësimit, çmon se vendimi i Komisionit nuk është i drejtë dhe i bazuar në situatën faktike të dokumentuar nga aktet në fashikull dhe nuk gjen mbështetje në kuadrin kushtetues e ligjor të zbatueshëm.

16.1 Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi përmbyllës i Komisionit: [...] *deduksioni logjik konsiston në faktin se askujt prej atyre që mund ta kenë humbur statusin e subjektit të rivlerësimit jo për vullnetin e tyre, pra pa dorëheqje, nuk mund t'i aplikohet ndalimi i parashikuar nga neni G, pika 2 e aneksit të Kushtetutës. Duke qenë se rasti konkret gjendet në këto kushte, për sa kohë humbja e pozicionit funksional të inspektore ka ardhur për shkak të lirimit nga detyra dhe jo nga dorëheqja, në konkluzion Komisioni çmon se për znj. Sofia Zhilla nuk duhet të aplikohet pika 2, e nenit G, të aneksit të Kushtetutës [...],* nuk qëndron referuar edhe orientimeve në jurisprudencën e Kolegjit për mënyrën se si duhet të analizohet situata faktike dhe ligjore, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, kundrejt përmbushjes së kriterëve që passjellin zbatimin e nenit G të aneksit të Kushtetutës, për sa do trajtohet në vijim:

16.2 Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 kanë parashikuar, në mënyrë të shprehur dhe shteruese, subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe ecurinë e procesit, pavarësisht dinamikës së rrethanave që ndikojnë në pozicionin për shkak të të cilit individët kanë fituar statusin e subjektit të rivlerësimit. Referuar akteve në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, ka punuar si inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë që nga viti 2013, dhe me vendimin nr. **, datë **.5.2018, i është zgjidhur mandati i inspektorit deri në krijimin e Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

16.3 Komisioneri Publik, në analizë të kuadrit kushtetues, ligjor dhe në vlerësim të rrethanave faktike që i përkasin subjektit, konstaton se në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁷, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Zhilla, ushtronte funksionin e inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Referuar kësaj dispozite, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton se subjekt rivlerësimi janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të

⁶ Anëtare kundër, kryesuese Etleda Çiftja.

⁷ Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit e ka fituar këtë status ligjor që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese e, për pasojë, do të duhej t'i nënshtrohej *ex officio* procesit të rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon këtë proces. Statusin e subjektit të rivlerësimit e parashikojnë dhe dispozitat ligjore të ligjit nr. 96/2016, pavarësisht pasjes apo jo të statusit të magjistratit, konkretisht:

16.4 Ligji nr. 96/2016, neni 165/Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë, në pikën 1, të tij, ndër të tjera, parashikon se: [...] dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” [...].

16.5 Po ashtu dhe neni 168/ Dispozita kalimtare për inspektorët me statusin e gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në pikën 1 të tij, ndër të tjera, parashikon se: [...] inspektori dhe Kryeinspektori në detyrë, të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ata i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” [...].

16.6 Në përfundim të kësaj analize, mbi kuadrin ligjor të zbatueshëm, Komisioneri Publik, vlerësimin e situatës faktike e vijon duke *abstraguar nga pasja apo jo e statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit*, për sa kohë parashikimi i nenit 179/b të Kushtetutës i jep inspektorit të KLD-së, që gjendet në këtë detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, statusin e subjektit të rivlerësimit, të pakushtëzuar nga pasja ose jo e statusit të magjistratit.

16.7 Komisioneri Publik vlerëson se znj. Zhilla në çdo rast e ka fituar *statusin ligjor të subjektit të rivlerësimit*, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese dhe ligjore e, për pasojë, ***si parakusht për vazhdimësinë e saj në detyrë, do të duhej t'i nënshtrohej ex officio procesit të rivlerësimit kalimtar***, në zbatim të kuadrit ligjor të sipërtrajtuar, i cili rregullon këtë proces.

16.8 Sa më sipër, një rëndësi thelbësore është analizimi i fakteve dhe rrethanave që tregojnë nëse subjekti i rivlerësimit, znj. Zhilla, hoqi dorë nga të drejtat që gëzonte nga statusi i inspektorit në ish-KLD, me vullnetin e saj apo nga ngjarje që nuk vareshin prej këtij vullneti, si dhe hapat proceduralë të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në rrugë gjyqësore mbi ruajtjen e marrëdhënies së punës në raport me qasjen e saj ndaj procesit të rivlerësimit.

16.9 Ashtu sikurse dhe Komisioni ka trajtuar në vendimin e tij, ka rezultuar se KLGJ, në mbledhjen e datës **.10.2019, ndër të tjera, bazuar në Raportin e Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka marrë vendimin nr. ***, duke *deklaruar mospasjen e statusit “Magjistrat”, për znj. Sofia Zhilla*. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me nr. ***, datë **.10.2019, “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën për znj. Sofia Zhilla”, duke vendosur: *Deklarimin e pasjes së statusit “Magjistrat”, për znj. Sofia Zhilla*.

16.9.1 Gjykata Administrative e Apelit⁸, me vendimin nr. **, datë **.2.2020, me shumicë votash, ka vendosur rrëzimin e padisë së paditëses Sofia Zhilla. Ndaj këtij vendimi, rezultoi se është paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe, në datën **.7.2020, dosja është dërguar në Gjykatë të Lartë, nga ku rezultoi e regjistruar⁹ me nr. çështje ***-***-**-2020, inicializuar rekurs, statusi në proces.

16.10 Po ashtu, rezultoi se KLGJ, në vijim të Raportit të Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka nxjerrë urdhrin nr. ***, datë **.11.2019, “Për lirimin nga detyra”, të inspektores së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të znj. Sofia Zhilla, për shkak të mospasjes së statusit të Magjistratit. Subjekti i rivlerësimit, me datë **.12.2019, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke kërkuar, ndër të tjera: [...] Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr.***, datë **.11.2019, “Për lirimin nga detyra”, të nxjerrë nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zgjidhjen e pasojës ligjore dhe detyrimin e palës së paditur KLGJ, që të rilidhë marrëdhëniet juridike të punës dhe ato financiare dhe detyrimin t’i paguajë pagën sipas detyrës që ka pasur [...].

16.10.1 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2020, ndër të tjera, ka vendosur: [...] Pranimin e padisë së paditëses Sofia Zhilla. Shfuqizimin e urdhrin nr.***, datë **.11.2019. Detyrimin e palës së paditur të rikthejë paditësen Sofia Zhilla në detyrën që ka mbajtur gjatë periudhës që ka punuar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke i paguar pagën që nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare me të, deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor... Ekzekutimi i këtij vendimi do kryhet nga pala e paditur brenda 2 (dy) muajve nga marrja e vendimit formë të prerë [...].

16.10.2 KLGJ ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr.***, datë **.2.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. **, datë **.6.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

16.10.3 Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.5.2024, ka informuar Komisionin se ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nga pala paditëse Sofia Zhilla, në datën **.4.2024, rekurs i cili është pranuar me vendimin për pranim rekursi në datën **.5.2024. Pas kryerjes të komunikimeve për rekursin e mësipërm në datën **.5.2024, kjo dosje do të dërgohet në Gjykatën e Lartë.

16.11 Komisioneri Publik konstaton se të dyja vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me vendimet e KLGJ-së, (1) vendimi për deklarimin e mospasjes së statusit, ashtu dhe (2) vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, janë në proces shqyrtimi gjyqësor pranë Gjykatës së Lartë, pasi për to është inicializuar rekurs nga vetë subjekti i rivlerësimit, duke dëshmuar kështu në të dyja rastet vullnetin e pavesuar të subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasjen e statusit “Magjistrat” si apo/dhe rikthimin në detyrën e inspektorit.

16.12 Ndërkohë, nga aktet rezultoi se vullneti i subjektit të rivlerësimit për qëndrimin e saj në detyrë, i shprehur në paditë e sipërtrajtuara, paralelisht përkon me shprehjen e vullnetit të saj të pavesuar për mos t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, gjatë avancimit të tij në Komision dhe komunikimit të vazhdueshëm, të dokumentuar sa vijon:

⁸ Referohuni përgjigjes së Gjykatës Administrative të Apelit me nr. ***/* prot., datë **.6.2023, në dosje të Komisionit.

⁹ <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/search?term=sofia%20zhilla>

16.12.1 *Me datë **.4.2023*, Komisioni i ka dërguar subjektit të rivlerësimit rinjoftimin për çeljen e hetimit administrativ, si dhe përbërjen e Trupës gjyquese së shortuar për rivlerësimin e saj. Nga Komisioni i është kërkuar subjektit të rivlerësimit verifikimi i adresave dhe saktësimi i tyre, pasi i është shkruar dhe më herët, më datë ****7.2021**, dhe ende nuk është marrë përgjigje.

16.12.2 *Më datë **.4.2023*, Komisioni duket se ka ridërguar *email*-in me njoftimin e mësipërm. Në këtë akt gjendet shënimi *email i nisur, pasi është kontaktuar nga Sekretaria në telefon më datë **.4.2023*.

16.12.3 *Po më datë **.4.2023*, Relatori i çështjes është vënë në dijeni nga Sekretaria se: [...] *Në kuadër të detyrës së ngarkuar për komunikim me SR Sofia Zhilla, ju informoj se pas kontaktimit të saj përmes numrit fiks të Komisionit (nuk u përgjigj në tentativën e parë për ta kontaktuar, por mori vetë më vonë) u shpreh: Po kam adresën e email-it ..., por nuk e hap shpesh duke qenë se kam tre vite që jam liruar nga detyra dhe kur isha në punë e hapja çdo mëngjes, tani kam kohë që nuk e hap kështu që nuk e kam parë email-in tuaj. Informohuni pranë qendrës time të punës, ndoshta është gabimi i tyre që nuk ju kanë njoftuar që jam liruar nga detyra. Duhet të kontaktoni qendrën e punës për mua madje, jo mua personalisht[...].*

16.13 Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë **.5.2023, ndër të tjera, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit, znj. Zhilla se: [...] *Nisur nga fakti se deri në këtë fazë ju nuk keni qenë bashkëpunuese në këtë proces, duam t'ju sjellim në vëmendje se ju keni detyrimin ligjor për t'ju përgjigjur njoftimeve të Komisionit, për sa kohë vijoni të jeni subjekt i rivlerësimit, edhe pse tashmë prej kohësh ju nuk e ushtroni më funksionin për të cilin jeni bërë subjekt rivlerësimi - pavarësisht faktit se nuk gëzoni statusin e magjistratit (aktualisht). Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, referuar parashikimeve ligjore, por edhe jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit, e vetmja rrugë ligjore për të ndaluar procesin e rivlerësimit është kërkesa juaj eksplicite për dorëheqje dhe ndërprerje të procesit të rivlerësimit, në të cilën duhet të parashtroni shkaqet që mund t'i vlerësoni, me kushtin që ato të përmbushin kriteret e parashikuara nga dispozitat ligjore përkatëse në këtë situatë [...].*

16.14 Subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës **.6.2023, protokolluar në Komision me nr. ***/* prot., datë **.6.2023, në përgjigje të njoftimit të Komisionit, ndër të tjera, është shprehur se: [...] *Quhem Sofia Zhilla, jam banore e qytetit të Tiranës. Dua të ju vë në dijeni se kam qenë inspektore pranë KLGJ-së nga viti 2013 deri në vitin 2019. Jam liruar nga detyra e Inspektore dhe nuk kam ndonjë funksion tjetër, pranë ndonjë institucioni të drejtësisë. Lirimi im është bërë me urdhrin nr.***, datë **.11.2019. Në këto kushte, kërkoj ndërprerjen e procedurave të hetimit administrativ për subjektin Sofia Zhilla dhe pushimin e çështjes [...].*

16.15 Në vijim Komisioni, me shkresën nr. ***, datë **.6.2023, i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit kërkesën për informacion, ndër të tjera, duke parashtruar se: [...] *Komisioni në vijim të kërkesës tuaj, të datës **.6.2023, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit tuaj kalimtar, në alternativë të vijimit të procesit të rivlerësimit tuaj, mund të konkludojë me një vendim të ndërmjetëm të këtij procesi (bazuar pikërisht në kërkesën dhe vullnetin tuaj), dhe duke aplikuar edhe dispozitën e parashikuar në nenin G, pika 2, të aneksit të Kushtetutës, pasi të ju dëgjojë ju në një seancë dëgjimore publike, nëse ju e vlerësoni të dobishme atë. Për sa më sipër, ju ftojme të shprehni qëndrimin tuaj për sa më lart, si dhe nëse ju dëshironi apo jo të paraqiteni në një seancë dëgjimore [...].*

16.16 Subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës **.7.2023, protokolluar në Komision me nr. ***/* prot., datë **.7.2023, në përgjigje të shkresës së Komisionit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Quhem Sofia Zhilla, jam banore e qytetit të Tiranës. Me shkresën tuaj të dytë me nr. **, datë **.6.2023, vihem në dijeni se Komisioni do të vijojë me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, mbi bazën e kërkesës sime datë **.6.2023, kërkesë e bazuar në statusin tim ligjor, lidhur me detyrën time si ish-inspektore pranë KLGJ-së, e liruar nga kjo detyrë në vitin 2019. Ju njoftoj se lirimi im nga detyra është bërë në kundërshtim me ligjin, nga drejtuesja e institucionit, për shkak të mosnjohjes së ligjit nga ana e saj. Nëpërmjet kësaj shkrese, më njoftoni të drejtën time për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, që ju do të zhvillonit, për të vijuar më tej me vendimmarrjen për ndërprerjen e hetimit administrativ. Duke Ju falënderuar për respektimin e të drejtave të mia, ju vë në dijeni se nuk do të marr pjesë në këtë seancë, pasi tashmë nuk kam asnjë detyrë shtetërore, që lidhet me procesin e rivlerësimit. Në këto kushte, paraqes qëndrimin tim, për vijimin e seancës, pa praninë time, duke kërkuar ndërprerjen e procedurave të hetimit administrativ, për subjektin Sofia Zhilla dhe pushimin e çështjes[...].*

17. Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në aktet në dosje, konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Zhilla, ka shprehur një vullnet të plotë, të pavesuar, të shkruar dhe të formalizuar për të pasur statusin e magjistratit apo/dhe inspektorit dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës, duke kundërshtuar në rrugë gjyqësore deri në Gjykatën e Lartë vendimet e KLGJ-së. Ndërkohë, në kushtet kur sipas legjislacionit të zbatueshëm, në të dyja rastet, pasja e statusit të magjistratit dhe qëndrimi në detyrë si inspektor, shoqërohet ngushtësisht me kalimin e procesit të rivlerësimit, ka kërkuar në Komision ndërprerjen e procedurave të hetimit administrativ, për subjektin Sofia Zhilla dhe pushimin e çështjes, duke e bazuar kërkesën e saj në faktin se është liruar nga kjo detyrë.

17.1 Për sa më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të mos i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, edhe ndërsa ajo vetë ka pretenduar gjyqësisht se e gëzonte statusin e magjistratit apo/dhe inspektorit që e bënte atë subjekt rivlerësimi, duke kërkuar dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm, rrethana të cilat përfaqësojnë një situatë të kualifikueshme sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës.

18. Po ashtu, rezulton se Komisioni në vendimin nr.767/2024, ndër të tjera, ka arsyetuar se – në mënyrë që të vlerësohej mundësia hipotetike e ndonjë vullneti për shmangien e procesit të rivlerësimit, me qëllim për të vijuar karrierën profesionale brenda sistemit të drejtësisë në ndonjë detyrë tjetër (të ndryshme nga ajo që i jepte statusin e subjektit të rivlerësimit) – ka verifikuar, për aq sa është mundur nga burimet e hapura dhe të aksesueshme, dhe nuk rezultoi që znj. Zhilla të jetë emëruar në ndonjë funksion tjetër pranë ndonjë institucioni të sistemit të drejtësisë, pas largimit të saj nga detyra në vitin 2019.

18.1 Komisioneri Publik konstaton se në aktet në dosjen e hetimit administrativ¹⁰, është administruar dhe vendimi nr. **, datë **.10.2020, i ILD-së: “Për ndalimin e kandidimit të znj. Sofia Zhilla në vendin vakant për inspektor jo magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën **.2.2020”, pasi kandidati gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për

¹⁰ Komisioni në vendim ka arsyetuar se – në mënyrë që të vlerësohej mundësia hipotetike e ndonjë vullneti për shmangien e procesit të rivlerësimit, me qëllim për të vijuar karrierën profesionale brenda sistemit të drejtësisë në ndonjë detyrë tjetër (të ndryshme nga ajo që i jepte statusin e subjektit të rivlerësimit) – ka verifikuar, për aq sa është mundur nga burimet e hapura dhe të aksesueshme, dhe nuk rezultoi që znj. Zhilla të jetë emëruar në ndonjë funksion tjetër pranë ndonjë institucioni të sistemit të drejtësisë, pas largimit të saj nga detyra në vitin 2019.

sa i përket verifikimit të pasurisë¹¹. Nga ky vendim rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, ka shprehur interesin për plotësimin e vendit vakant *inspektor jomagjistrat*, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

19. Në përfundim, Komisioneri Publik, në analizë të rrethanave të faktit, kuadrit ligjor të zbatueshëm si dhe jurisprudencës së Kolegjit, thekson se zbatimi i nenit G, pika 2 e aneksit të Kushtetutës është pasojë ligjore e drejtpërdrejtë e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për të gjithë subjektet e rivlerësimit, të cilët me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procesit të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në funksion të kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik, në rrethanat konkrete dhe provat e administruara, vlerëson se vendimi i Komisionit është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

IV. Kërkimi i ankimit

20. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;

20.1 Referuar nenit F dhe G, të aneksit të Kushtetutës, jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkohet që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 767, datë 29.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur:

1. *Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, znj. Sofia Zhilla.*
2. *Ndalimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.*

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

¹¹ ILDKPKI, në përfundim të shpjegimeve të kandidatit, të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e shpjegimeve të kandidatit, të gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara në institucionet publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit Sofia Zhilla, ka arritur në përfundimin se: (a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë, të ardhurat e djalit në SHBA; (c) ka mosdeklarim të pasurisë; (d) nuk ka kryer deklarim të rremë; (e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.